



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1355, datë. 06.08. 2010

Për

“Mbylljen e procedimit administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreshjes se interkoneksionit midis sipermarresve alternative dhe Albtelcom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Anilda Mulgeci, në mbledhjen e datës 06.08.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Mbylljen e procedimit administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreshjes se interkoneksionit midis sipermarresve Alternative dhe Albtelcom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.”, te shoqeruar nga:

- Raport permbledhes (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**projektakti**);
- Dokumentet shkresore te paleve (**Provat, pretendimet**):

BAZA LIGJORE :

1. Neni 120 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 66-104 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin e miratuar me VKD nr. 416, date 7.12.2007 e zevendesuar me Rregulloren e miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010;
4. Rregullore per Procedurat e Zgjidhjes se Momarreveshjeve e miratuar me VKD nr. 1296, date 11.06.2010;
5. Ofertate Referenca e Interkoneksionit te AMC, Vodafone Albania dhe Albtelecom.
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, te perbere nga:

1. Vendimi nr. 1279, date 20.05.2010 i KD per “Fillimin e procedimit administrativ mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve alternative dhe Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
2. Shkrese e AKEP nr. 2312/2 prot, date 20.05.2010 “Njoftim Vendimi nr.1279 date 20.05.2010 te KD te AKEP”, drejtuar sipermarresve alternative, Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
3. Shkrese e Vodafone Albania sh.a nr. 2312/1 prot, date 26.05.2010 “Kerkim njohje me ankesat dhe ankimimet administrative te paleve te tjera ne kuader te VKD nr. 1279, date 20.05.2010 “Per fillimin e procedimit administrative per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis sipermarresve alternative, Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
4. Shkrese e AKEP nr. 2312/8 prot, date 10.06.2010, drejtuar Vodafone Albania “Ne pergjigje te shkreses Tuaj nr.2212/1, date 26.05.2010”, bashkelidhur shkresat e Sipermarresve (ankimimet administrative);
5. Shkrese e Mobik sh.p.k nr 2312/6 date 07.06.2010 “Pretendimet e pales ankimuese Mobik sh.p.k per mos lidhjen e MI me sipermarresin AMC”;
6. Shkrese e Primo nr. 2312/4 prot, date 07.06.2010 “Dergohen te dhenat e kerkuara me VKD te AKEP nr.1279 date 20.05.2010”;
7. Shkrese e Telecom Postriba sh.p.k nr. 2312/7 prot, date 08.06.2010 “Pergjigje e AKEP ne lidhje me VKD nr. 1279 date 20.05.2010 dhe pretendimet e Telecom Postriba per ceshtjen e deshtimit te thirrjeve te abonenteve te saj drejt operatoreve celulare”;
8. Shkrese e Albtelecom sh.a nr. 2312/9 prot, date 14.06.2010 “Mbi depozitimin e pretendimeve te Albtelecom ne zbatim te VKD nr. 1279 date 20.05.2010”;

9. Shkresë e Primo nr. 2500 prot, datë 23.06.2010 “Mbi zbatimin e MI midis Primo dhe vodafone Albania sh.a”;
10. Shkresë e Mobik sh.p.k nr 2312/10 datë 30.06.2010 “Takimi i zhvilluar midis Mobik sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi lidhjen e MI, jashtë procedimit administrativ të nisur në AKEP”;
11. Shkresë e Vodafone Albania sh.a nr. 2312/11, datë 06.07.2010 “Prapësimet e Vodafone Albania sh.a mbi procedimin administrativ për zgjidhje mosmarrëveshje Interkoneksioni midis sipërmarrësve Alternative, Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
12. Projektvendim i KD të AKEP për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr.1279, datë 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Alternative dhe Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a (**Projektvendimi**);
13. Raport përmbledhës mbi projektvendimin (**Raport**);
si dhe,
14. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;
15. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

- I.** Në vijim të Vendimit nr. 1279, datë 20.05.2010, “Për fillimin e procedimit administrativ mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Alternative dhe Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a (AMC) dhe Vodafone Albania sh.a”, palët kanë depozituar pretendime meshkrim si më poshtë:
 1. **Sipërmarrësi Mobik sh.p.k** ka paraqitur pretendimet me anë të shkresës nr.2312/5 datë 07.06.2010 drejtuar AKEP dhe për dijeni AMC , me anë të se ciles sqaron se:
 - Mobik sqaron se nga pikepamja procedurale duke iu referuar pikës 3.3 të RIO kërkesa e AMC sh.a për dërgim informacioni të detajuar, përben shkelje të kushteve të RIO-s, pasi është kryer në tejkalim të afatit 15 ditor dhe konsiderohet si veprim abuziv dhe në kundërshtim me përcaktimin e RIO-s. Lajmerimi duhet të përmbajë një listë të detajuar pyetjesh dhe kërkesash mbi të dhënat teknike që nuk janë siguruar në deklaratën e kushteve të paraqitura nga Operatori Perfutues dhe jo në kërkesën për informacion paraprak.
 - Lidhur me pretendimin e AMC për pamundësi teknike, Mobik mendon se është AKEP organi që duhet të certifikojë pretendimin e AMC dhe jo vetë AMC. Për, asnjë operator i interesuar për interkoneksion nuk mund të bazohet vetëm në një deklaram të njëanshem për mungesë kapaciteti, pa patur garancinë e nevojshme nga organi kompetent rregullator;

- Ne mungese te certifikimit nga AKEP te pamundesise teknike te AMC per interkoneksion dhe per shkak se kane kaluar disa muaj nga paraqitja e kerkeses per interkoneksion, Mobik pretendon se AMC ka kapacitetet e nevojshme teknike per interkoneksion;
- Mobik i gjendur ne kushtet e parashikuara ne piken 1 te nenit 50 te ligjit 9918 mbi moslidhjen e marreveshjes se interkoneksionit per shkak te sjelljes abuzive ne kundershtrim me percaktimet ligjore te sipermarresit AMC sh.a, me shkrese date 06.04.2010 paraqiti ankimin administrativ ne AKEP, duke kerkuar nxjerrjen e Urdherit sipas procedures se percaktuar ne nenin 60 te ligjit 9918.
- Mobik shpk me shkrese date 21.05.2010 i drejtohet perseri AMC sh.a dhe ve ne dijeni AKEP-in se pavaresisht faktit se gjenden ne mosmarreveshje, duke patur bindjen se kerkesa per interkoneksion eshte e drejte dhe e bazuar ligjesisht, propozoi nje zgjidhje jashte trajtimit administrativ te ceshtjes nga AKEP. Edhe pas ketij propozimi nga ana e AMC nuk pati asnje reagim, duke renduar ne kete menyre poziten si shkaktar i demit dhe i shkeljes se ligjit.

Bashkengjitur shkrases se Mobik, gjendet korrespondenca shkresore e Mobik me AMC.

2. **Gjithashtu Mobik** sh.p.k ka depozituar pretendimet e tij me ane te shkreses nr.2312/6, date 07.06.2010 drejtuar AKEP dhe per dijeni **Vodafone Albania sh.a.** Ne shkrese ajo sqaron se:

- Mobik sqaron se nga pikepamja procedurale duke iu referuar pikes 3.3 te RIO kerkesa e Vodafone Albania sh.a per dergim informacioni te detajuar, perben shkelje te kushteve te RIO-s, pasi eshte kryer ne tejkalim te afatit 15 ditor dhe konsiderohet si veprim abuziv dhe ne kundershtrim flagrant me percaktimin e RIO-s. Lajmerimi duhet te permbaje nje liste te detajuar pyetjeshdhe kerkesash mbi te dhenat teknike qe nuk jane siguruar ne deklaraten e kushteve te paraqitura nga Operatori Perfitues dhe jo ne kerkesen per informacion paraprak.Vodafone Albania sh.a nuk e ka marre aspak ne konsiderate informacionin e derguar nga Mobik shpk me shkresen 08.02.2010 si dhe detyrimin e rregullave te percaktuara ne ligjin 9918, Rregullore dhe RIO, duke abuzuar keshtu me pozitat e saj si FNT.
- Mobik i gjendur ne kushtet e parashikuara ne piken 1 te nenit 50 te ligjit 9918 mbi moslidhjen e marreveshjes se interkoneksionit per shkak te sjelljes abuzive ne kundershtrim me percaktimet ligjore te sipermarresit Vodafone Albania sh.a, me shkrese date 06.04.2010 paraqiti ankimin administrativ ne AKEP, duke kerkuar nxjerrjen e Urdherit sipas procedures se percaktuar ne nenin 60 te ligjit 9918.
- Sipas Mobik, sipermarresi Vodafone Albania, ne reagim ndaj ankimit te paraqitur ne AKEP nga Mobik shpk, me date 19.04.2010 i drejtohet me shkrese AKEP-it dhe per dijeni Mobik duke pretenduar se i ka kerkuar disa here Mobik te negociojne, fakt i cili sipas Mobik shpk, nuk eshte i vertete. Mobik sqaron se sipermarresi Vodafone Albania per te njejtin sherbim ka lidhur MI me operatore te tjere, provuar kjo me Vendim nr.1059, date 25.11.2009 te Keshillit Drejtues te AKEP me ane te te cilit eshte urdheruar lidhja e MI;
- Kerkesa e Mobik, shoqeruar me deklaraten perkatese mbi kushtet teknike per vendosjen e interkoneksionit me qellim ofrimin e sherbimit te njoftuar, bazohet ne detyrimet ligjore

lidhur me aksesin dhe interkoneksionin te percaktuarane nenin 42 e vijues te ligjit nr.9918, Rregullores per aksesin dhe interkoneksionin dhe RIO-s se sipermarresit Vodafone Albania te miratuar nga AKEP. Per kete arsye, ne zbatim te nenit 48 te ligjit 9918 ka kerkuar fillimin e menjehershem te negociatave per lidhjen e MI si dhe deklaroi plotesimin e te gjitha kushteve dhe kerkesave te bazuara ne keto akte ligjore e nenligjore, duke perfshire dhe garancine finaciare sipas Aneksit VII te RIO-s.

Bashkengjitur shkreses nr. 2312/6 date 07.06.2010 se Mobik shpk, gjendet korrespondenca shkresore Mobik me Vodafone.

3. **Shoqeria Mobik sh.p.k** me shkresen nr.42/2010, date 26.06.2010, drejtuar AKEP, “Mbi takimin e zhvilluar midis Mobik shpk dhe Vodafone Albania sh.a per zgjidhjen e mosmarreshjes per lidhjen e Marreshjes se Interkoneksionit, jashte procedimit administrativ te nisur nga AKEP”, bejne me dije se Perfaqesuesit e Mobik realizuan nje takim me perfaqesuesit e Vodafone Albania duke bere edhe nje perpjekje per zgjidhjen e mosmarreshjes ne rruge jo administrative per arritjen e pranimit te lidhjes se MI dhe me date 14.06.2010.

Ne kete takim Mobik parashtrroi per te disaten here per Vodafone Albania mbi bazen e mundesive reale se kerkesa minimale e tij per kapacitete E1, nuk eshte nje por 10 te tilla dhe aktualisht pas 4 muajsh nga data e paraqitjes se kerkeses per interkoneksion (08.02.2010) kerkesa per shtim kapacitetesh eshte rritur ne 15 E1.

Mobik argumenton se:

- Moslidhja e marreshjes se interkoneksionit sipas afatit te procedures sipas nenit 46 e vijues i ka shkaktuar Mobik sh.p.k nje dem pasuror dhe moral te konsiderueshem;
 - Pretendimet e sipermarresit Vodafone Albania per mosdhenien dhe paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit te kerkuar ne RIO per lidhjen e MI, jane te pabazuara dhe jo te drejta;
 - Interpretimi i sipermarresit Vodafone Albania sh.a, se sipas RIO-s kapaciteti fillestar E1 qe ata duhet ti japin nje sipermarresi tjetere eshte 1 (nje) eshte nje interpretim i gabuar dhe jo i drejte. RIO percakton se kapaciteti E1 minimal qe duhet te jepet eshte 1 dhe kjo eshte e natyrshe, sepse pa nje te tille nuk mund te ekzistoj MI, por ky jo se ky percaktim perben nje detyrim te paengociushem kur nevoja minimale e kerkuesit per kapacitete E1 nuk eshte 1 por 10 te tilla. Mobik argumenton me fakte se nevoja e tyre fillestare per kapacitete E1 ishte 10;
 - Kerkesa e Vodafone Albania per paraqitjen e elementeve te fundit teknike dhe alokimin e SPC te miratuar nga AKEP eshte e padrejte dhe e panevojshme duke patur parasysh skemen teknike dhe natyrene sherbimit qe do te ofroje Mobik si dhe dokumentacionin e paraqitur bashkerisht me kerkes fillestare per Interkoneksion me date 08.02.2010. Kerkesa per alokimin e SPC te miratuar nga AKEP nuk i eshte parashtruar sipermarresve te tjere nga Vodafone Albania me te cilet Vodafone ka lidhur MI.
4. **AMC sh.a me ane** te shkreses nr.2312/3, date 07.06.2010 “Pergjigje shkreses me nr. 2313/2, date 26.05.2010”, drejtuar AKEP ka depozituar pergjigjen e saj mbi vendimin nr.1279, date 20.05.2010 te Keshillit Drejtues te AKEP “Per fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarreshje interkoneksionit midis sipermarresve alternative dhe Albtelecom sh.a, AMC sh.a, Vodafone Albania sh.a” duke sqaruar se:

- AMC ne pergjigje te pikes 3 dhe 4 te vendimit nr.1279 te AKEP dhe shkresave te Albtelecom me nr.8667/1, date 09.12.2009 dhe nr.8712, date 10.012.2009, ka organizuar me Albtelecom dy takime te perbashketa ne ambientet e AMC dhe Albtelecom, ne te cilat eshte diskutuar situata teknike per problemet e parashtruara dhe menytrat per tu zgjidhur keto probleme. Problemet e parashtruara nga Albtelecom jane zgjidhur, kapacitetet per te cilat eshte rene dakord sipas kontrates jane aktive dhe me parametra cilesore brenda kufijve te lejuar. ***Ky fakt ka zgjidhur njekoheisht ankesat e operatoreve, Sabatel, Rutel, Sintel, Tele Co & Construction, Telecom Postriba, Enada Online etj;***

- ***AMC*** ne pergjigje te pikes 5 te vendimit nr.1279, mbi ankesen e operatorit ***Nisatel***, sqaron se i eshte drejtuar shoqerise Albtelecom sh.a me ane te shkreses nr. 6097, date 02.11.2009, ku e informon se Nisatel nepermjet Albtelecom ka terminuar trafik me CLI te modifikuar. AMC thekson se Nisatel eshte ne shkelje te dispozitave te MI ne lidhje me modifikimin e CLI-se. Per kete fakt AMC ka njoftuar Albtelecom dhe ka vene ne dijeni AKEP se operatori Nisatel dhe operatore te tjere kane modifikuar dhe vazhdojne te modifikojne CLI;

- ***AMC pretendon se problemi me Enada Online eshte zgjidhur pas takimeve dhe konfigurimeve te reja midis AMC dhe Albtelecom;***

- ***AMC per sa i perket shoqerise IT-Tel***, me date 08.01.2010 i eshte drejtuar Albtelecom, duke e bere me dije se operoretet US-Partner, It-tel, ATN, Vraniger, Sajet kane terminuar trafik ne rrjetin e AMC me CLI te modifikuar. Per qartesimin e kesaj suate kane ndihmuar raportet teknike per secilin operator. Operoretet kane shkelur dispozitat e ligjit dhe kushtet e kontratave perkatese ne te cilat percaktohet qarte se nuk lejohet modifikimi i CLI. Keta operore kane shkaktuar probleme lidhur me cilesine e sherbimit si dhe ankesa nga abonentet. AMC i ka kerkuar Albtelecom qe te rregulloje situaten me keta operore ne baze te marredhenieve kontraktuale qe ka me ta. Albtelecom ka percjelle shqetesimin e AMC te gjithe operoreve. Pas ketij njoftimi disa prej tyre e kane nderprere trafikun me CLI te modifikuar, ndersa te tjeret perfshire IT-Tel nuk e kane nderprere;

- ***AMC per Primo***, shprehet se eshte lidhur direkt me te dhe se bashkepunimi ka qene korrekt. Primo i eshte shpjeguar se situata e krijuar ka ardhur si rrjedhoje e kapaciteteve te kufizuara, hapësirave te kufizuara si me dhomen e switch-ve apo problemet me hapësirat per kabllot e fibrave optike te cilat nuk kane me vend per kabllot te reja. Ceshtja me e rendesishme eshte se, kapacitetet e kufizuara jane krijuar per shkak edhe te nje upgrade te gjere te switch-ve te AMC, i cili eshte i domosdoshem per dy arsye:
 - a) Centralet e AMC jane ne operim qe prej vitit 2000, pra i perkasin nje kategorie te vjeteruar (lejojne interkoneksion vetem ne nivel E1 dhe jo STM1, fiber etj)

- b) Meqenese ndodhet perpara zhvillimeve te reja sic jane Portabiliteti i Numrit dhe 3G, ky upgrade qe permendem me siper behet akoma me i domosdoshem per te pergatitur infrastrukturen e rrjetit tone per te qene e gatshme qe te perballoje keto teknologji.

AMC shprehet se eshte ne kushtet e kalimit ne gjeneraten e re te switcheve (MSS/MGW), proces i cili eshte i komplikuar dhe i kushtueshem dhe kerkon kohe duke patur parasysh procedurat e prokurimit dhe te dizenjimit, shperndarjes dhe te migrimit.

- **AMC** ne lidhje me sipermarresin **ATN**, thekson se eshte sqaruar ne menyre te detajuar me ane te shkreses nr.570/1, date 12.03.2010;

 - ***Pas takimeve dhe konfigurimeve te reja midis AMC dhe Albtelecom eshte zgjidhur dhe problemi i shoqerise Tele Co& Telegroup.;***

 - AMC ne lidhje me kerkesen e shoqerise Mobik, sqaron se Mobik i eshte drejtuar me ane te nje kerkese e cila eshte shqyrtuar me kujdes per zgjidhje teknike dhe i eshte kerkuar informacion me i detajuar. Njekohesisht AMC ka informuar Mobik se ndodhet ne veshtiresi per kapacitete. Por edhe pas ketyre shpjegimeve Mobik ka bere ankim prane AKEP. AMC shpjegon se ne shkresat e derguara nga Mobik nuk mund te konstatojne se kush eshte administrator i kesaj shoqerie, pasi shkresat vijne me emra te ndryshem dhe ne disa prej tyre mungojne emri dhe firma e personit dergues, gje e cila sipas AMC nuk eshte aspak serioze. AMC thekson se Mobik nuk ka ezauruar fazen e negociatave mes paleve, por thjesht dergon kerkesat e veta pa marre parasysh qe dhe kompanite e tjera kane nje planifikim paraprak sidomos ne lidhje me aspektet e veta teknike te zhvillimit te rrjetit dhe buxheteve te viteve perkatese.
5. ***Shoqeria Primo***, me ane te shkreses nr. 2312/4 date 07.06.2010 drejtuar AKEP , “Dergohen te dhenat e kerkuara me vendimin nr.1279, date 20.05.2010 te AKEP”. Ne zbatim te ketij vendimi ka paraqitur te dhenat per trafikun e shkembyer me ***AMC dhe Vodafone Albania*** pretendimet lidhur me mosrespektimin nga ana e AMC-se se detyrimeve qe ajo ka ne baze te MI lidhur me date 22.05.2009 dhe amenduar me amendamentin e dates 01.05.2010.
- Bazuar ne Aneksin V, Procedura e parashikimit te Kapacitetit, paragrafi 5.6, Primo i eshte drejtuar AMC-se me date 24.07.2009 per zgjerim te kapacitetit ekzistues. AMC i eshte pergjigjur me date 27.10.2009 dhe nuk i jep asnje zgjidhje problemit qe ka krijuar mungesa e kapacitetit shtese te kerkuar;

 - Po e njejta situatë eshte perseritur edhe me Vodafone Albania te cilit i eshte drejtuar me ane te shkreses nr. 597, date 18.08.2009, per t’i kerkuar shtimin e kapacitetit te interkoneksionit, ne perputhje me MI me kete FNT te lidhur me date 01.04.2009;

- Pergjigja e ardhur me vonese nga Vodafone Albania, ka qene negative dhe e justifikuar me pamundesine teknike per te bere shtimin e kapacitetit te interkoneksionit, pa percaktuar afate te metejshme;
- Primo sqaron se ka kryer bisedime me AMC dhe Vodafone Albania, por te gjitha kane rezultuar te pa suksesshme;

Bashkengjitur gjenden te dhenat mbi trafikun e shkembyer me AMC sh.a dhe Vodafone sh.a.

6. Shoqeria Telekom Postriba sh.p.k me shkrese date 07.06.2010 (AKEP:2312/7 date 08.06.2010) "Pergjigje AKEP ne lidhje me Vendimin nr.1279, date 20.05.2010 dhe pretendimet e Telekom Postriba sh.p.k per ceshtjene deshtimit te thirrjeve te abonenteve te saj drejt operatoreve celulare", drejtuar AKEP dhe per dijeni Altelecom sh.a.

- Ne kete shkrese Telekom Postriba sqaron se, nuk ben tranzitim thirrjesh telefonike nderkombetare dhe te gjitha thirrjet e gjeneruara qe vijne nga pajtimtaret e saj jane me CLI origjinale dhe nuk ka patur asnjehere raste te ndryshimit te saj.
- Abonentet e Telekom Postriba kane shprehur pakenaqesi lidhur me kete problem pasi rezulton se 90% e thirrjeve te abonenteve deshtojne drejt AMC gjithashtu 50% e thirrjeve te abonenteve deshtojne drejt Vodafone Albania;
- Telekom Postriba konsideron se Altelecom edhe pse eshte ne dijeni prej kohesh e ka zvarritur kete kete problem duke mos investuar AKEP-in ne kohen e duhur per vendimmarrje;
- Ne perfundim te pretendimeve te saj, Telekom Postriba kerkon zgjidhjen sa me shpejt te ketij problemi dhe marrjen e masave nga ana e AKEP qe keto probleme te mos perseriten ne te ardhmen.

7. Altelecom sh.a me shkrese nr.2580/1, date 11.06.2010 (AKEP: nr.2312/9 date 14.06.2010) "Mbi depozitimin e pretendimeve ne zbatim te vendimit nr.1279, date 20.05.2010 te Keshillit Drejtues te AKEP", ka paraqitur sqarimet e tij si me poshte vijon:

- Albetecom pasi eshte vene ne dijeni te ankesave te disa operatoreve alternative ka ndermarre veprimet e nevojshme, duke kryer verifikimet perkatese teknike dhe duke kontrolluar menjehere situaten ne qarqet e interkoneksionit me rrjetet celulare;
- Albetecom ka kontaktuar ne rruge elektronike me AMC dhe Vodafone per te prezantuar ankesat e Operatoreve Alternative, duke vijuar me shkresa zyrtare Nr.8667/1, date 09.12.2009 "Per trafikun nga operatoret Alternative drejt rrjetit AMC" dhe shkresa nr.8667 date 09.12.2009 "Per trafikun nga operatoret Alternative drejt rrjetit Vodafone", per te cilat ende nuk eshte marre pergjigje zyrtare.
- Nga konstatimet ne qarqet e interkoneksionit rezultoi i nevojshem shtimi i kapaciteteve ne qarqet e interkoneksionit me AMC dhe Vodafone Albania per trafikun e tranzituar, per kete arsye Albetecom i eshte drejtuar Vodafone Albania me shkrese nr.8711, date 10.12.2009 "Kerkese shtese kapaciteti per tranzitimin e thirrjeve te Operatoreve Alternative drejt Vodafone Albania" si dhe AMC-se me shkrese Nr.8712, date

10.12.2009 “Kerkese per aktivizim e E1 te qarkut te interkoneksionit” duke kerkuar stabilizimin e E1 te dyte te me AMC.

- Albtelecom thekson se ne kohen e pergatitjes per negociatat per nenshkrimin e MI, u ak kerkuar operatoreve Alternative te benin parashikimet e trafikut vecanerisht drejt rrjeteve te operatoreve celulare ne menyre qe te benin planifikimet perkatese per kapacitetet e interkoneksionit, por reagimet e operatoreve perballe kesaj kerkese te RIO-s kane qene te vonuara dhe ne shifra mjaft modeste ne krahasim me trafikun e realizuar drejt rrjeteve celulare. Kjo sjellje e operatoreve ka sjelle veshtiresi per Albtelecom per mbulimin me garanci financiare per kete trafik si ne lidhje me operatoret alternative ashtu dhe ne raport me operatoret celulare;
- Albtelecom ngre problemin se ofrimi i sherbimit te tranzitimit per operatoret alternative po has probleme shqetesuese nga fenomeni i fshehjes dhe modifikimit ndryshimit te CLI.
- Se fundmi Albtelecom e konsideron te papershtatshme thirrjen e saj si pale ne kete mosmarveshje interkoneksioni. Albtelecom pretendon se do te ishte me vend qe te thirrej si pale e interesuar duke qene se garanton dhe eshte ne gjendje te provoje se cdo ankese e ardhur nga sipermarresit, pjese e ketij procedimi administrativ, eshte trajtuar dhe vleresuar ne kohen dhe menyren e duhur.

8. *Shoqeria Primo Communications sh.p.k* me shkresen nr. 2500 prot date 23.06.2010 “Mbi zbatimin e MI midis Primo dhe Vodafone Albania sh.a”

- Pas nenshkrimit te MI-se, u konstatua se kapaciteti i interkoneksionit nuk ishte i mjaftueshem per te perballuar volumin e trafikut te gjeneruar nga abonentet e PRIMO dhe volumin e tranzitimit.
- Per kete arsye, bazuar ne MI, Aneksi V, paragrafi 5.6, pikat (a) dhe (b), Primo ju drejtua Vodafone Albania me nje kerkese zyrtare per te rritur kapacitetin e interkoneksionit edhe me nje E1;
- Vodafone Albania me shkrese te dates 31.08.2009 i eshte pergjigjur Primo, se per momentin kishte kapacitete te kufizuara;
- Primo thekson se edhe pas diskutimeve dhe takimeve dypaleshe te vazhdueshme me perfaqesues te Vodafone Albania, nuk eshte realizuar rritja e kapaciteteve te kerkuara;
- Ne keto kushte Primo, i eshte drejtuar AKEP per zgjidhjen e kesaj situate.

Bashkengjitur gjendet korrespondenca shkresore e mbajtur me Vodafone Albania:

- Shkresa nr.597, date 18.08.2009 e shoqerise Primo drejtuar Vodafone Albania, per rritje te kapacitetit te interkoneksionit;
- Email i Vodafone Albania drejtuar Primo, pergjigje per shkresen nr. 597, date 18.08.2009.

9. *Vodafone me shkresen nr.2312/11 date 06.07.2010* “Prapesimet e Vodafone Albania mbi procedimin administrativ per zgjidhje mosmarveshje interkoneksioni midis sipermarresve Alternative dhe Albtelecom sh.a, AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a (VKD nr. 1279 daet 20.05.2010)”. Vodafone deklaroi se pergjate gjithe praktikes se saj te interkoneksionit me operatoret e tjere ne tregun e komunikimeve elektronike ka vepruar ne perputhshmeri te plote me kuadrin ligjor dhe rregullatore ne fuqi.

Per sa me siper Vodafone paraqet prapesime si me poshte vijon:

- **Ankesat e Albtelekom** ne lidheje me shkresat nr. 8667 date 09.12.2009 sipas te ciles operoret alternative Sin Tel, TeleCo Construction dhe Nisatel kane paraqitur ankesa per probleme ne realizimin e trafikut drejt rrjetit Vodafone. Vodafone ne lidheje me kete ceshtje shprehet se nese ka patur nje tejngopje te kapaciteteve transmetuese te trafikut kjo ka ardhur per shkak te mungeses se parashikimit te trafikut nga Albtelecom, i cili mbart dhe detyrimin rregullator per ta bere kete gje. MI e lidhur midis Albtelecom dhe Vodafone ne Aneksin V rregullon proceduren e parashikimit te kapaciteteve te interkoneksionit konkretisht pika 5.6 parashikon se ekzistenca e kerkeses se duhur per trafik eshte kusht paraprak per instalimin e qarqeve te interkoneksionit. Kjo kerkese duhet paraqitur qe ne momentin kur perdorimi i zakonshem i kalon 75% te kapacitetit, nderkohe qe kerkesa eshte bere kur tafiku ka qene mbi 100% te kapacitetit te shfrytezimit. Nderkohe Albtelecom ka dergur per Vodafone shkresen nr.8711 date 10.12.2010 ku kerkohet rritje kapaciteti, pra iniciativa e marre nga Albtelecom ka qene e vonuar, megjithate Vodafone ka treuar gadishmerine per t'iu pergjigjur situates ne varesi edhe te kapaciteteve disponibel, duke shtuar nje E1 tjetër ne dispozicion te tranzitimit nga Albtelecom.
- Me shkresen nr. 8711 date 10.12.2010 operatori **Albtelecom** ka paraqitur kerkesen per rritje kapaciteti transmetimi dhe pretendon se nuk ka marre pergjigje, nderkoh Vodafone kete pretendim e hedh poshte duke na informuar se me date 22.12.2009 ka kthyer pergjigje me email brenda afateve procedurale. Nepermjet ketij njoftimi me poste elektronike Vodafone ben me dije Albtelecom se ashtu si parashikohet ne piken 4.2 te Aneksin IV te MI (Planifikimi i rrjetit) ***“Vodafone ka planifikuar ndryshime te medha ne rrjet qe afektojne direkt sherbimin e interkoneksionit. Ky projekt parashikohet te perfundohet ne majin Mars dhe do te sjell dhe zgjerim te portave te interkoneksionit , ndaj nuk ekzistojne mundesite reale per nje zgjerim te mundshem deri ne kete periudhe”***. Te njejtin qendrim Vodafone ka mbajtur me te gjithë operoret e tjere qe kane paraqitur kerkesa per interkoneksion duku i'u njoftuar si afat muajin Mars.
- **Ne lidheje me ankesen e Sipermarresit Enada Online nr. 12/4** date 12.04.2010 dhe shkresat nr.5 date 05.02.2010, nr.16/2 date 16.02.2010 **“Per probleme ne realizimin e trafikut drejt rrjetit Vodafone nepermjet tranzitimit nga Albtelecom dhe per rrjedhoje perkeqesimi i trafikut ka ardhur si pasoje e:**
 - a. Mosparashikimit ne kohe nga Albtelecom te rritjes se trafikut;
 - b. Mosnjoftimit me kerkese drejtuar Vodafone (Si kusht paraprak per rishikim kapaciteti);
- ***Kjo analize per Vodafone vlen jo vetem per Enada Online por per te gjithë sipermarresit e tjere Alternative te cilet tranzitojne ne rrjetin e Vodafone nepermjet Albtelecom***
- Vodafone, mbi pretendimet e sipermarresit **Nisatel**, se po has ne nje suate problematike ne lidheje me interkoneksionin, pervec analizes se mesiperme sqaron se Vodafone eshte shprehur qartesisht pergjate gjithë korrespondences se eshte e gatshme qe ne cdo moment te vendos marreveshje direkte me Nisatel, persa kohe qe Nisatel shkeput lidhjen tranzitore. ***Ligji nr. 9918 vendos detyrimin mbi Vodafone per te dhene interkoneksion, detyrim te cilin Vodafone e ka realizuar duke i ofruar Nisatel interkoneksion nepermjet***

tranzitimit me Albtelecom. Vodafone sqaron se ligji nr. 9918 nuk vendos detyrim mbi operatoret FNT per te ofruar interkoneksion te dyfisht, tranzitor edhe te drejtperdrejt.

- **Vodafone Albania mbi pretendimet e Mobik sh.p.k**, sqaron se ka respektuar detyrimin e tij si OFNT per te lidhur marreveshje interkoneksioni me Mobik sh.p.k ne perputhje me standartet dhe afatet qe parashikohen ne ligjin nr. 9918, ne rregulloren e interkoneksionit si dhe ne RIO-n e Vodafone Albania, por ka hasur ne mungese vullneti per te bashkepunuar dhe per tu takuar fizikisht me perfaqesuesit e Mobik per te diskutuar termat e marreveshjes se interkoneksionit. Vodafone Albania thekson se ne dokumentacionin fillestar per MI nga Mobik sh.p.k mungonin:
 1. Kopje e Autorizimit te pergjithshem te leshuar nga AKEP;
 2. Kopje e njoftimit per Autorizimit te pergjithshem te leshuar nga AKEP;
 3. Kodet e pikave te sinjalizimit te leshuar nga AKEP (dokumentin e alokimit te SPC)
 4. Garancia financiare.
- Por edhe pas takimit te mbajtur me 14.06.2010, Mobik sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar nga Vodafone Albania dhe nuk ka pranuar te negocioj sipas modaliteteve te RIO;
- Nder te tjera Vodafone Albania thekson se ka pasur:
 - a. Perqindje te larte te thirrjeve me CLI te modifikuar dhe;*
 - b. Nivel te larte te thirrjeve jo te suksesshme;*

Bashkengjitur prapesimeve te Vodafone Albania gjenden evidencat e 2 muajve te fundit 27.04.2010-26.06.2010, ku reflektohen qarte operatoret qe dergojne thirrje me CLI te modifikuar nder te cilet listohen Nisatelsh.p.k dhe Mobitel WLC.

- Vodafone Albania parashton kerkesen ndaj AKEP per rishikim te konceptit te "Konxhestionit" ne dokumentat rregullatore perkates, ne kete kuader nevojitet te riformulohet treguesi i cilesise mbi konxhestionin dhe perdorimin e qarqeve;
- Vodafone Albania propozon nje afat 15 ditor si minimalisht te mjaftueshem per matje te njepasnjeshme te cilat do mund te perdoren si periudhe vleresimi per shkallen e utilizimit te kapaciteteve.

III. Ne perfundim te shqyrtimit te pretendimeve :

1. Kerkesat e disa operatoreve alternative qe kerkojne lidhje direkte interkoneksioni ose shtim te kapaciteteve ekzistuese, jane refuzuar nga -AMC dhe Vodafone Albania, me pretendimin se nuk kane mundesite teknike duke perdorur si arsye edhe upgrade-in e centraleve/rrjetit.

- a. ATN v AMC: moslidhje MI
 - b. Mobik v AMC: moslidhje MI
 - c. Mobik v Vodafone: Molidhje MI
 - d. Nisatel v Vodafone: moslidhje MI
 - e. Primo v AMC: mos-shtim kapacitete
 - f. Primo v Vodafone: mos-shtim kapacitete
2. Kapacitetet e interkoneksionit midis Albtelecom dhe dy operatoreve celulare, per tranzitim e trafikut te operatoreve alternative nuk jane te mjaftueshem per te perballuar trafikun e percjelle nga OA drejt OC, neperemjet Albtelecom, duke rezultuar ne bllokime te thirrjeve, dhe duket se kjo eshte arsyeja kryesore qe nje numer i konsiderueshem OA kerkojne lidhje direkte me OC. Operatoret qe kane raportuar probleme me trafikun drejt celulareve, te tranzituar nga Albtelecom jane **Telecom Postriba, Enada on line dhe Telegroup Albania**
 3. Trafiku i percelle nga OA drejt rrjeteve celulare, direkt apo indirekt (neperemjet Albtelecom), shpesh ka probleme ne lidhje me CLI, pasi sipas operatoreve celulare ka CLI te modifikuar. Operatoret celulare kane shprehur ankese per trafikune percjelle nga operatoret **IT Tel dhe Nisatel**

1. Mundesite teknike te OC

OC kane justifikuar mos-lidhjen e marrveshjes se interkonkesionit apo shtimin e kapaciteve ekzistuese me operatoret e cituar ne piken 1 me siper, per shkak te pamundesise teknike.

Operatori ofruer i interkoneksionit (AMC apo Vodafone) nuk mund te detyrohet te ofroje akses per interkoneksioni kur nuk ekzistojne mundesite teknike. Megjithate, ne baze te pikes 4, seksioni I, kreu IV i Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit miratuar nga ERT me VKD nr.416 date 7.12.2007 (ne fuqi ne kohen e mosmarrveshjes) dhe pikes 4 te nenit 6¹ te Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit miratuar nga AKEP me VKD nr.1300 date 14.06.2010 (ne fuqi prej dates 10.07.2010):

- Operatori ofruer, në rastet kur refuzon t'i sigurojë operatorit përfitues shërbimet e specifikuara në ofertën referencë dhe e motivon këtë refuzim me mungesën e mundësive teknike, ai ka detyrimin t'i paraqesë operatorit përfitues një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të refuzimit dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin kërkesa do të përmbushet. Kur operatori ofruer refuzon të sigurojë shërbimet e specifikuara në ofertën referencë për operatorin përfitues për shkak të kriterëve të tjera të përmendura në pikën 2 të këtij neni, operatori ofruer duhet, gjithashtu, të specifikojë kushtet që duhet të plotësojë operatorin përfitues me qëllim që operatorin ofruer të jetë në gjendje të përmbushë kërkesën. Për secilin rast të specifikuar në këtë paragraf, kur operatorin ofruer paraqet shpjegime për operatorin përfitues, kopje të këtyre shpjegimeve i depozitohen

¹ Permbajtja e te percaktimeve ne ted y rregulloret, sipas referncave te dhena) eshte e njejte. Me siper eshet dhene percaktimi I rregullores aktuale te interkoneksionit.

njëkohësisht dhe AKEP-it.

Nderkohe edhe në rast të vertetimit të pamundësive teknike të AMC/Vodafone, shpjegimet e dhena nuk kanë përfshirë afate kohor të sakta se kur mund të përmbushen kërkesat përkatëse. Çka është në kundërshtim me rregulloren e Akses dhe Interkoneksionit (të re dhe të mëparshme).

Interkoneksioni midis Nisatel dhe Vodafone është realizuar nëpërmjet Albtelcom, pra të dy rrjetet janë interkonektuar në mënyrë indirekte duke përdorur shërbimet e tranzitimit të Albtelcom. Është realizuar interkonektimi i rrjeteve. Nisatel kërkon një lidhje shtesë direkte me Vodafone, për të eliminuar problemet e trafikut të tranzituar nga Albtelcom. Ky problem mund të zgjidhet:

- Nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të tranzitimit Albtelcom-OC, duke bërë shtesat e nevojshme në lidhjet midis këtyre operatoreve
- Realizimi direkt i interkoneksionit Nisatel-Vodafone, sipas mundësive teknike të Vodafone. Në këtë rast Nisatel, do të duhet të mos tranzitojë thirrje drejt Vodafone nëpërmjet Albtelcom. Përdorimi i lidhjes me Albtelcom si back-up, nuk është i pranueshëm, pasi normalisht palet duhet të realizojnë back-up me lidhje direkte dhe jo indirekte.

Kërkesat e Primo për shtesë kapacitetesh me AMC/Vodafone, rezultojnë se janë bërë në përputhje me parashikimet e RIO-ve dhe MI-ve përkatëse.

Interpretimet e Vodafone Albania dhe AMC se kapaciteti fillestar E1 që ata duhet të japin një operatori që kërkon interkoneksion për here të parë është 1 E1 është një interpretim i gabuar dhe jo i drejtë, pasi ky kapacitet është kapaciteti minimal dhe jo maksimal.

Aktualisht mund të ekzistojë një problem pamundësie teknike për OC, pasi shtimi i madh i numrit të OA të interkonektuar direkt me AMC dhe Vodafone, krijon probleme në kapacitete/hapësira fizike, por njëkohësisht ky numër i madh i kërkesave për interkoneksion direkt është i lidhur me cilësinë e ulët të tranzitimit të Albtelcom drejt OC, për shkak të kapaciteteve të kufizuara të interkoneksionit Albtelcom-OC, të trajtuar me poshtë.

2. Lidhjet e interkoneksionit Albtelcom-OC për tranzitimin e thirrjeve të OA

Albtelcom ka bërë kërkesën për shtim kapacitetesh, por kërkesat e Albtelcom në këtë rast varen nga parashikimet e OA për trafikun drejt rrjeteve celulare dhe sipas shpjegimit të Albtelcom, këto parashikime kanë qenë të vonuara. Sipas të dhënave të trafikut të përcjelle dhe ankesave për bllokim, është e nevojshme që kapacitetet e tranzitimit midis Albtelcom dhe OC për trafikun e OA të shtohen në mënyrë të ndjeshme. Kjo kërkon që Albtelcom të bazojë kërkesën në trafikun e përcjelle drejt rrjeteve celulare në 6 muajt e fundit (përfshirë thirrjet e deshtuara për shkak të kapaciteteve) dhe në parashikimet e OA për periudhat e mëvonshme. Në rast se është e nevojshme për investime shtesë në qarqet e tranzitimit Albtelcom-OC (të dedikuara për OA), të cilat kryhen për shkak të kërkesave të OA për më shumë trafik, OA duhet të paguajë për këto shtesa, proporcionalisht me trafikun që parashikojnë dhe që do të dergojnë për terminim në rrjetet celulare. Përdorimi (lejimi nga OC) i plotë i kapaciteteve aktuale mund të kryhet menjëherë, pas

daljes se vendimit, ndersa per rritjen e kapaciteve deri ne nivelin e kerkuar nga Albtelcom, AKEP gjykon se dy muaj jane te mjaftueshem.

3. Problemet e CLI dhe cilesise

Modifikimi i CLI perben shkelje te kuadrit rregullator dhe ligjor, dhe bazuar ne Rregulloren e Aksesit dhe interkoneksionit, pikat 9 dhe 10 te nenit 5, pala jo ne shkelje ka te drejte te nderprese interkoneksionin, ndersa pala e pretenduar ne shkelje (qe i eshte nderpre interkoneksioni) ka te drejte te beje ankese ne AKEP.

Per sa me siper AKEP gjykon te arsyeshme, se per realizimin e objektivave te ligjit 9918 dhe konkurrencen e ndershme ne treg, eshte e nevojshme:

- a. AKEP te urdheroje lidhje te Marrveshjes se Interkoneksionit midis AMC dhe ATN, Mobik, dhe midis Vodafone dhe Nisatel, Mobik brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te vendimit dhe urdherit perkates, dhe qe brenda 30 diteve te realizohet implementimi i interkoneksionit dhe ofrimi i sherbimeve nga AMC dhe Vodafone
- b. AKEP te vendose ne favor te shtimit te kapaciteve midis AMC-Albtelcom, Vodafone –Albtelecom per trafikun e operatoreve alternative;
- c. AKEP te vendose ne favor te shtimit te kapaciteve AMC-Primo dhe Vodafone-Primo;
- d. AKEP te vendose, per implementimin e nje lidhje shtese si back-up me te pakten 1 E1, per cdo interkonektim direkt midis operatoreve ne kete procedim si dhe operatoret te tjere ne treg. Kjo lidhje shtese back-up duhet te siguroje funksionimin e interkoneksionit ne rast te defekteve te linjes baze si dhe te sherbeje perkohesisht per te kaluar trafikun shtese ne rast te mbingarkimit te linjave ekzistuese baze.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme, Keshilli Drejtues,

V E N D O S:

1. Te mbylle procedimin administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreshjes se interkoneksionit midis sipermarresve Alternative dhe Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.
2. Sipermarresi Albanian Mobile Communications sh.a:
 - i. brenda nje muaji nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, te lidhe marreshje interkoneksioni me ATN dhe Mobik;
 - ii. jo me vone se 30 dite nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, te filloje ofrimin ne menyre efektive te sherbimeve te interkoneksionit per ATN dhe Mobik;
 - iii. jo me vone se 30 dite nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi te kete realizuar shtimin e kapaciteteve te interkoneksionit me Albtelecom dhe Primo sipas kerkesave te ketyre sipermarresve;
3. Sipermarresi Vodafone Albania sh.a:
 - i. brenda nje muaji nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, te lidhe marreshje interkoneksioni me Nisatel dhe Mobik;
 - ii. jo me vone se 30 dite data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, te filloje ofrimin ne menyre efektive te sherbimeve te interkoneksionit per Nisatel dhe Mobik;
 - iii. jo me vone se 30 dite nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi te kete realizuar shtimin e kapaciteteve te interkoneksionit me Albtelecom dhe Primo sipas kerkesave te ketyre sipermarresve;
4. Sipermarresit Vodafone Albania sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a., ne lidhjet e interkoneksionit midis tyre si dhe me operatoret alternative jane te detyruar te kerkojne vendosjen e nje lidhje shtese si back-up me te pakten 1 E1, per cdo interkonektimi direkt midis operatoreve ne kete procedim si dhe operatoreve te tjere ne treg. Keto lidhje shtese back-up duhet te sigurojne funksionimin e interkoneksionit ne rast te defekteve te linjes baze si dhe te sherbejne perkohesisht per te kaluar trafikun shtese ne rast te mbingarkimit te linjave ekzistuese baze. Keto linja shtese interkoneksioni duhet te fillojne te funksionojne jo me vone se tre muaj nga data e ketij vendimi.
5. Pagesat per investimet shtese te imponuarar ne pikat 2, 3 dhe 4 te ketij vendimi, duhet te paguhen nga operatoret qe i kerkojne keto invetsime shtese, sipas tarifave aktuale te operatoreve me FNT dhe te aplikuarra me operatoret e tjere.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen e Internetit të AKEP.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Keshilli Drejtues

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .08. 2010

U R D H E R
Nr.06, date 06.08.2010

Per

“Lidhjen e Marreveshjes per Akses dhe Interkoneksion midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe ATN sh.p.k”

Ne mbeshtetje te nenit 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues (VKD) te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010, Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, VKD nr.1355,date 06.08.2010 **“Mbylljen e procedimit administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve Alternative dhe Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”**.

U R D H E R O J :

1. Albanian Mobile Communications sh.a dhe ATN sh.p.k te lidhin marreveshje interkoneksioni brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij urdheri.
2. Marreveshja e Interkoneksionit te lidhet sipas percaktimeve te ofertes reference te interkoneksionit ne fuqi te Albanian Mobile Communications, dhe marrveshjeve te lidhura me palet e tjera;
3. Palet te depozitojne ne AKEP nje kopje te Marreveshjes te Interkoneksionit te nenshkruar nga palet brenda 15 diteve nga data e nenshkrimet.

4. Moszbatimi i ketij urdheri perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe sipas parashikimeve te nenit 137 te ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit te tij ne faqen e Internetit te AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Keshilli Drejtues

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .08. 2010

U R D H E R
Nr.07, date 06.08.2010

Per

“Lidhjen e Marreveshjes per Akses dhe Interkoneksion midis Vodafone Albania sh.a dhe Nisatel sh.p.k”

Ne mbeshitetje te nenit 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues (VKD) te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010, Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, VKD nr.1355, date 06.08.2010 “**Mbylljen e procedimit administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve Alternative dhe Albtelcom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”**”.

U R D H E R O J :

1. Vodafone Albania sh.a dhe Nisatel sh.p.k te lidhin marreveshje interkoneksioni brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij urdheri.
2. Marreveshja e Interkoneksionit te lidhet, sipas percaktimeve te ofertes reference te interkoneksionit ne fuqi te Vodafone Albania, dhe marreveshjeve te lidhura me palet e tjera.
3. Palet te depozitojne ne AKEP nje kopje te Marreveshjes te Interkoneksionit te nenshkruar nga palet brenda 15 diteve nga data e nenshkrimet.
4. Moszbatimi i ketij urdheri perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe sipas parashikimeve te nenit 137 te ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen e Internetit të AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Keshilli Drejtues

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .08. 2010

U R D H E R
Nr.08, date 06.08.2010

Per

“Lidhjen e Marreveshjes per Akses dhe Interkoneksion midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Mobik sh.p.k”

Ne mbeshitetje te nenit 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues (VKD) te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010, Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, VKD nr.1355, date 06.08.2010 “**Mbylljen e procedimit administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve Alternative dhe Albtelecom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”**”.

U R D H E R O J :

1. Albanian Mobile Communications sh.a dhe Mobik sh.p.k te lidhin marreveshje interkoneksioni brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij urdheri.
2. Marreveshja e Interkoneksionit te lidhet sipas percaktimeve te ofertes reference te interkoneksionit ne fuqi te Albanian Mobile Communications dhe marreveshjeve te lidhura me palet e tjera.
3. Palet te depozitojne ne AKEP nje kopje te Marreveshjes te Interkoneksionit te nenshkruar nga palet brenda 15 diteve nga data e nenshkrimet.
4. Moszbatimi i ketij urdheri perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe sipas parashikimeve te nenit 137 te ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen e Internetit të AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Keshilli Drejtues

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .08. 2010

U R D H E R
Nr.09, date 06.08.2010

Per

“Lidhjen e Marreveshjes per Akses dhe Interkoneksion midis Vodafone Albania sh.a dhe Mobik sh.p.k”

Ne mbeshitetje te nenit 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues (VKD) te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010, Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, VKD nr.1355, date 06.08.2010 “**Mbylljen e procedimit administrative te filluar me VKD nr.1279, date 20.05.2010, mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve Alternative dhe Albtelcom sh.a, Albanian Mobile Communications sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”**”.

U R D H E R O J :

1. Vodafone Albania sh.a dhe Mobik sh.p.k te lidhin marreveshje interkoneksioni brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij urdheri.
2. Marreveshja e Interkoneksionit te lidhet sipas percaktimeve te ofertes reference te interkoneksionit ne fuqi te Vodafone Albania, dhe marrveshjeve te lidhura me palet e tjera.
3. Palet te depozitojne ne AKEP nje kopje te Marreveshjes te Interkoneksionit te nenshkruar nga palet brenda 15 diteve nga data e nenshkrimtit.
4. Moszbatimi i ketij urdheri perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe sipas parashikimeve te nenit 137 te ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen e Internetit të AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**